



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HAS  
Njësia e Prokurimit

Data 12/06/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Rehabilitim kunete dhe bazamentit i kanalit te betonit perroi i tershenes segmenti Ish ura ushtrise vazhdim drejt grykë tershenes”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Sherbime të pastrimit dhe kanalizimit: Punime ndertimi per kanale ujtese (45247111-1); Punime ne kanalizime (45232410-9); Kanalizime kryesore (44130000-0); Punime perforcim betoni (45262310-7); Punime veshje betoni (45262370-5).

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 5,622,856.0 (pesëmilion e gjashtëqint e njëzet e dymijë e tetëqint e pesdhjetë e gjashtëmijë) lekë pa tvsh, financim i buxhetit Bashkise Has viti 2023, të vëna në dispozicion nga Buxheti i bashkisë Has (Fondi Emergjencave-VKM Nr. 260, datë 27.04.2023);

Në bazë të nenit 21(Autoriteti ose enti kontraktor), pika 2 (Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit), të Ligjit [Nr.](#) 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2(Dokumentimi i procesit), pika 2/c (2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:/ c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit)

dhe nenit 78 (Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit), pika 2 (2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. ...), të VKM [Nr.](#) 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia HAS**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76 (*Kriteret detyruese për skualifikim*), 82 (*Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*) dhe 83 (*Sigurimi i ofertës*) të LPP ([Nr.](#) 162/2020 “Për prokurimin publik”), dhe nenin 26 (*Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*), të VKM [Nr.](#) 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

a) Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të ketyre DT (FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT, pika 1: Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit)

b) Licence profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, e vlefshme me kategoritë: **N.P-1A** Punime gërmimi në tokë; **N.P-4A** Rrugë,....; **N.P-5A** ...ura dhe vepra arti; **N.P-12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit; **NS-18A** “Punime topogjeodezike”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (*Kërkesat për kualifikim*), pika 1/a (*a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale*) dhe 2 (*...një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*), të LPP ([Nr.](#) 162/2020 “Për prokurimin publik”), nenin 39 (*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*), pika 6/b (*6....për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;*), të VKM [Nr.](#) 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

Si dhe në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave [Nr.](#) 42, datë 16/01/2008, “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM [Nr.](#) 534, datë 25.07.2019. Për këto operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e ri të miratuar me VKM [Nr.](#) 42 datë 16/01/2008.

---

(Shënim: përcaqtoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e

*prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare: **2020, 2021, 2022** ku vlera e xhiros për të paktën **një nga vitet** e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël** se 40% e fondit limit të prokuruar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 (*Kërkesat për kualifikim*), pika 3 (*Në lidhje me situatën ekonomike,.... entet kontraktore mund të vendosin kërkesa,.....*) e LPP (**Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**), si dhe nenin 43 (*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*), **pika 2(c)** (c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar), të VKM **Nr. 285**, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në: VKM **Nr. 285**, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 55** (*Procedurë e hapur e thjeshtuar*); “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet: **40 %** të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar parashikimeve ligjore të **nenit 43** (*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*), **pika 1**, (*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*), për procedurat në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të vertetuara të bilanceve vjetore të viteve **2020, 2021, 2022** të paraqitura pranë administratës tatimore **dhe të konfirmuara me nenshkrim dhe vulosura** nga ky institucion (ç’do fletë), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, **vetëm** në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c” të Ligjit **Nr.10091**, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 (*Kërkesat për kualifikim*), pika 3 (*Në lidhje me situatën ekonomike,.... entet kontraktore mund të vendosin kërkesa,.....*) e LPP (**Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**), si dhe **nenit 43** (*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*), **pika 4** (...*autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e*

tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare,...), të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit [Nr. 10091](#), date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, (ku parashikohet se: “nenit 41 -Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”). **Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit**”. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. si dhe VKM-së [Nr. 922](#), datë **29.12.2014**, "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".**

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Vertetim të lëshuar nga autoritetet locale (ku operatori ka seline dhe aktivitetin sipas **OKB**) për shlyerjen e detyrimeve (taksave-trarifave) vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, 2022, 2023) në vendet ku ka ushtruar aktivitet (sipas **Ekstraktit**). Në rastin e bashkimit të operatoreve çdo operator duhet të dorëzojë këtë vertetim dhe sipas vendodhjes. Për pagesën e taksave dhe tarifave vendore kërkohej vertetimi i likuidimeve të detyrimeve ndaj pushtetit vendor.

Referuar ligjit [Nr. 9632](#), datë **30.10.2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka seline dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Referuar ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit që tregon kryerjen e detyrimeve taksave dhe tarifave vendore, është bërë referuar ligjit [Nr. 9632](#), datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka seline dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Referuar ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB).

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e zhvillimit të proc nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**Kontrata punimeve; - Situacioni perfundimtar; -Aktin e kolaudimit; - Çertifikate e marrjes ne dorezim; - Reference (Formulari Vlerësimit) e leshuar nga investitori per punimet e ngjashme te realizuara per tre vitet e fundit (2020, 2021,2022), ku te jete e percaktuar vlera e kontrates se realizuar, koha e realizimit te punimeve, natyra e punes se bere.**

Per raste te pervojës se meparshme te realizuar ne sektorin privat kerkohet te paraqitet formulari i vleresimit i shoqeruar me: - **Kontraten e punimeve; - Lejen e ndertimit dhe te shfrytezimit leshuar nga njesia vendore perkatese; - Situacionin perfundimtar; -Faturat tatimore perkatese; - Aktin e kolaudimit - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.**

**2.3.2** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

**2.3.3** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

*(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 (Kërkesat për kualifikim, pika 1/c) aftësinë teknike dhe profesionale, pika 4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, .... AK kerkojne nga OE .... një nivel të mjaftueshëm përvojë, .... përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën), të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike), pika 5 (Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës....; b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet).

(ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM [Nr.](#) 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme)

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, **ose jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera **në 5 vitet e fundit**, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Neni 77, ligji [Nr.](#) 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (**Kërkesat për kualifikim**), **pika 1.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet .... dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, **ose jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera **në 5 vitet e fundit**, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. neni 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike), pika 5, të VKM [Nr.](#) 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, **Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4/a, germat “i” dhe “ii”**.

---

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga **Ministria Infrastruktues dhe Energjise**, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

a. **Licence profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, e vlefshme me kategoritë: N.P–1A Punime gërmimi në tokë; N.P–4A Rrugë,.. ura, mbikalime,..; N.P–5A ...ura dhe vepra arti; N.P-7A “Ujësjetës, -----, vepra kullimi e vaditje”N.P–12A Punime të inxhinierisë së mjedisit; NS-18A “Punime topogjeodezike”.**

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **si dhe në referim të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42** date 16/01/2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar me VKM [Nr. 534](#), datë 25.07.2019. Per kete operatoret ekonomike duhet te paraqesin licencen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e ri te miratuar me VKM [Nr. 42](#) date 16/01/2008.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve object kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. **Nje punesim mesatar i te pakten 20 (njëzet) punonjesve, te vertetuar me:**

Vertetim te leshuar nga Admnistrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen **Shtator 2022- Maj 2023** (vertetime me nenshkrime elektronike).

Te deshmohe me vertetim te leshuar nga administrate tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (**Formulari E-Sig 02/a**) (*vertetime me nenshkrime elektronike*), liste pagesat e punonjesve per periudhen e mesiperme te jene te konfirmuara (*vertetime me nenshkrime elektronike*) te (formulet E-SIG 025/a), si dhe urdher pagesat e shlyerjes se detyrimeve te sigurimeve shoqerore sipas afateve ligjore (*vertetime me nenshkrime elektronike*).

**2.3.6.** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Per realizimin e kontrates operatori duhet te kete te punesuar dhe stafin teknik te meposhtem: **Inxhinier ndërtimi 1(nje); Inxhinier Hidroteknik 1(nje); Inxhinier topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një);**
- b. Kandidati ofertues duhet te percaktoje me ane te nje **deklarate** (nga Administratori i Shoqerise) **Drejtuesin/(t) Teknik** te punimeve ne object dhe te deklarroje se ai/ata do te jete/jene i/te pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne object, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:
  - i. Diplome +CV, Librezat e punës
  - ii. Kontrate pune te **noterizuar**, te vlefshme deri ne perfundimin e kontrates

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar / kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet / kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime / kualifikime).*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si me poshte:

- 1 (nje) punonjës teknik Ndertimi
- 1 (nje) punonjës teknik Topograf
- 2 (dy) punonjës Hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës Karpantjer

Per stafin e mesiperm duhet te figurojne ne liste pagesat e kompanise si të tillë të paktën **3 muajt Mars-Maj 2022.** (te shoqeruar me **Kontrate** pune te **noterizuar**, **Diplome** dhe **CV, Libreze Pune**):

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 (4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie), të nenit të 77, të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ (c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.



(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

	<b>LLOJI I MAKINERIVE</b>	<b>PRONESIA</b>	<b>SASIA</b> <i>Minimumi</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>2 copë</i>
3	<i>Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
4	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
5	<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
6	<i>Fadroma me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
7	<i>Minieskavator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
8	<i>Autobote uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
9	<i>Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
10	<i>Autorimorkiator/terheqes mjetesh</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
11	<i>Vibratore betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
12	<i>Betoniere 0.5m3</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 20 (njetet) cope
- Jelek Pune 20 (njetet) cope
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 (tre) cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjete) cope.

a) *Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe per mjetet e siguruar me qera(e noterizuar), dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates object i ketij prokurimi.*

- b) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet **Licence & Certifikate Transporti, bazuar në ligjin Nr. 8308, datë 18.3.1998, “PËR TRANSPORTET RRUGORE”, i ndryshuar, të ligjit nr.8378, date 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë ligjit nr. 139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 15, date 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor".**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39(Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike), pika 6/ç dhe 6/d, të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht: **Vendim i KM Nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”**

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

*Shënim: Autoreteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikata te leshuara nga organe teavarura, qe vertetojne pajtueshmerine e tyre me standartete e kerkuara te cilesise, perfshire:**

- a. Shoqeria duhet te paraqese Çertifikate **ISO 9001-2015 (e vlefshme)**, “Per menaxhimin e cilesise se punimeve”, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. ne rast bashkimi operatoresh cdo operator duhet te paraqes Çertifikate **9001-2015 (e vlefshme)** dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- b. Shoqeria duhet te paraqese Çertifikate **ISO 45001-2018 (e vlefshme)**, “Per menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit”, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. ne rast bashkimi operatoresh cdo operator duhet te paraqes Çertifikate **9001-2015 (e vlefshme)** dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;

**2.4.2** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit personel të kualifikuar/ certifikuar ne baze të VKM-së Nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1 b:

- 1 (një) punonjes inxhinier të disponojë certifikatë si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date

18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar).

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP(Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"), si dhe nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

Njësia e prokurimit për këtë objekt prokurimi:

- Artiola	Morina	Kryetare	_____
- Avni	Muhadri	Anëtar	_____
- Elsa	Lala	Anëtare	_____